



Arrete e vendosur dhe
Zbardhur nga Komiteti i
Kontrollimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI



Nr. 2457 Prot.

Vlorë më, 29.10.2024

VENDIM

Nr. 20, datë 24.10.2024

PËR

PËR PLANIFIKIMIN E SHPËRNDARJES SË ORËVE TË PRAKTIKËS MËSIMORE, NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 40, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Rektorati në mbledhjen e datës, 24.10.2024,

VENDOSI:

1. Praktikat mësimore planifikohen në ngarkesën mësimore të pedagogut në bazë të orëve fizike të ndjekjes së praktikës prej pedagogut, jo në bazë të planit mësimor të studentit.
2. Drejtuesi i Njesisë Bazë bën planifikimin e shpërndarjes së orëve të ngarkesës së praktikës mësimore për çdo pedagog, me argumentimin përkatës. Orët kur pedagogët monitorojnë praktikat në institucione paraqiten në orarin mësimor të fakultetit dhe shënohen në rregjistrat e pedagogut.
3. Planifikimi i orëve të praktikës së pedagogut duhet të llogaritet brenda 300 orëve totale të mbingarkesës.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Njësitë kryesore dhe Njësitë Bazë në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Aurela Saliaj

